



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 405, date 27.07.2000

PER

KUSHTET E NXJERRJES SE PULLES POSTARE SHQIPTARE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te pikes 3, te nenit 11, te ligjit nr.8530, date 23.09.1999, "Per Sherbimin Postar ne Republiken e Shqipterise", me propozimin e ministristrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit, Keshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Pulla postare shqiptare, me cilesin e letres me vlere, sherben per pagesen e sherbimive qe kryejne zyrat e "Albapost", sha per pranimin, transportimin dhe shperndarjen e leterkembimit postar.

2. Prane DP-se funksionon komisioni shteteror i pulles postare shqiptare. Kryetari i ketij komisionit eshte drejtori i Drejtorise se Pergjithshme te Postave dhe Telekomunikacioneve dhe ne perberje ka personalitete te njohura te shkences, kultures, artit, perfaqesues te shoqatave te filatelisteve, si dhe perfaqesues nga "Albapost" sha..

Anetaret e ketij komisioni emerohen nga ministry.

3. Percaktimi i tematikave vjetore behet nga komisioni shteteror i pulles postare shqiptare. Si rregull, tematika caktohet brenda tremujorit te pare te vitit paraardhes, duke u

mbeshtetur ne propozimet e sjella nga ministrite, institucionet e tjera skencore, artistike si dhe shoqatat e ndryshme lidhur me natyren e fushes se veprimtarive te tyre bazuar kjo ne kerkesen e DPPT-se.

4. Emetimi, venia dhe heqja nga qarkullimi i cdo emisioni te pullave postare shqiptare miratohet nga drejtori i Drejtorise se Pergjithshme te Postave dhe Telekomunikacioneve.

5. Çmimi i shitjes se pullave postare shqiptare per nevojat e sherbimit postar nuk mund te jete me i vogel se vlera nominale e shenuar ne pulle. Çmimi dhe tirazhi i çdo emisioni miratohet nga ministri me propozimin e "Albapost" sha, ne perputhje me tarifat e miratuara dhe nevojat e sherbimit postar, si dhe kerkesat e sherbimit filatelik.

6. Per veprimtarine qe kryejne, anetaret e komisionit shteteror te pulles postare shqiptare marrin nje shperblim vjetor, masa e te cilit caktohet me udhezim te veçante te ministrit, dhe perballohet nga "Albapost" sh.a.

7. Pullat postare shqiptare shtypen ne ente te specializuara, te zgjedhura ne mbeshtetje te dispozitave ne fushen e prokurimeve. Ne cdo rast, konkurentet duhet te jene te pajisur me dokumentacionin e nevojshem per shtypjen e letrave me vlere.

Shtypja dhe marrja ne dorezim, administrimi, shperndarja dhe shitja e pullave postare shqiptare behet nga "Albapost" sh.a., ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, te cilat rregullojne sherbimet e letrave me vlere.

8. Per pergatitjen e skicave dhe te bocetave te emisioneve te pullave postare shqiptare, te percaktuara ne tematiken vjetore, organizohet konkurs. Kriteret e shpalljes se konkursit dhe dhenia e çmimeve vendosen sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 595, date 29.12.1993 "Per Kriteret e shpalljes se konkurseve me karakter kombetar e lokal dhe dhenien e cmimeve per to".

Te gjitha punimet e paraqitura ne konkurs ruhen ne "Muzeun e pulles postare shqiptare".

Shperblimi i autoreve te shpallur fitues, behet nga "Albapost" sha. Masa e shperblimit per fituesit, nga i pari tek i treti, caktohet nga keshilli mbikqyres i "Albapost" sh.a. me propozim te kesaj te fundit.

9. "Albapost" sha organizon shitjen e pullave per nevojat e sherbimit nepermjet zyrave te postes, si dhe subjekteve te tjera, ne baze te kontrates te lidhur me to.

10. Shitja e pullave postare shqiptare per qellime filatelike, brenda dhe jashte vendit, behet nga "Albapost" sha nepermjet shoqerive dhe agjensive tregtare vendase ose te huaja. Per shitjen ne sasi te medha, ne tregun filatelik, "Albapost": sh.a. zbaton zbritje kundrejt çmimit nominal, si vijon:

- a) per seri te plota, te pavulosura deri ne masen 20%;
- b) per seri te shkurtuara, te vulosura deri ne masen 80%;
- c) per emisionet e mbetura stok, te emetuara deri ne vitin 1993, vlera nominale e te cilave eshte shprehur ne qindarka dhe ne leke, deri ne masen 30% kundrejt vleres se konvertuar ne dollare amerikane, sipas kursit te kembimit te periudhes perkatese te emetimit te serise, me te cilen eshte percaktuar çmimi i shitjes ne dollare amerikane.

Sasite e shitjes se pullave postare shqiptare, per te cilat zbatohen zbritjet ne perputhje me germat e mesiperme; "a", "b", "c", percaktohen me udhezim te veçante te ministrit.

11. Per emisionet e mbetura stok, qe kane humbur mundesine e perdorimit per afrankim, si dhe qe, per shkak te qendrimit te gjate kane humbur parametrat cilesore filatelike, "Albapost" sh.a. ka te drejten e asgjesimit te tyre, duke zbatuar dispozitat ligjore ne fuqi.

12. "Albapost" sha ben publikimin e pullave postare shqiptare, nepermjet materialave informative, reklamimit, simpoziumeve dhe pjesmarrjes ne ekspozita e panaire kombetare e nderkombetare.

13. "Muzeu i pulles postare shqiptare", administrohet nga "Albapost" sha ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per ruajtjen e vlerave muzeale.

14. Ngarkohet ministri, te nxjerre udhezimet perkatese ne zbatim te ketij vendimi.

15. Vendimi nr. 497, date 13.8.1998 i Keshillit te Ministrave "Per pullen postare shqiptare", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi me botimin ne Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

ILIR META